



Pranuar / Dorezuar Prilipno / Prilipno Received / Delivered	22-04-2022	2	viti god year
Organ / Njesia Organ / Jedinica Org / Unit	Nr Prot Br / Prez Prot No	Shtori / Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKAMSHICK	2338/2022		115



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A.nr.225/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në përbërje nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca -anëtarë, me Flakron Gashi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.225/2022 të datës 11.03.2022 e parashtruar nga ankuesi me adresë banimi:

kundër Vendimit numër: 01/194 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Malishevës i datës 08.02.2022, në çështjen juridike "Ndërprerje e Marrëdhënies së Punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës. në seancën për këshillim dhe votim, me datë 22.04.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. REFUZOHET si e pabazuar ankesa me numër A.nr.225/2022 e datës 11.03.2022 e parashtruar nga ankuesi.
- II. MBETET në fuqi Vendimi numër: 01/194 i Komisionit Disiplinor të Komunës së Malishevës i datës 04.02.2022.

A r s y e t i m

Ankuesi, sipas shkresave të lëndës i punësuar në Komunën e Malishevës, me datë 12.11.2022 ka kërkuar pushim pa pagesë në kohëzgjatje prej një (1) viti, ndërsa Kryetari i Komunës me datë 21.01.2022 ka nxjerrë aktvendimin përmes së cilit kërkesën e ankuesit për pushim pa pagesë e ka refuzuar për shkak të mungesës së dëshmive.

Ankuesi kundër aktvendimit të datës 21.01.2022 të Kryetari të Komunës së Malishevës ka parashtruar ankesë përmes postë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e cila në Këshill është pranuar me datë 10.02.2022 dhe është protokolluar me numër:656/2022.

Po ashtu, ankuesi kundër Vendimit numër: 01/194 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Malishevës i datës 04.02.2022 ka parashtruar ankesë me datë 09.03.2022 nëpërmjet poste në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil e cila në Këshill është pranuar me datë 11.03.2022 dhe është protokolluar me numër: 1611/2022.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, me datë 18.03.2022 dhe datë 15.03.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në të dy ankesat e ankuesit te Komuna e Malishevës. Këshilli me datë 10.02.2022 dhe 30.03.2022 ka pranuar përgjigje në ankesë nga Komuna e Malishevës, me shkresat e bashkangjitura të lëndës.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, meqenëse objekti i shqyrtimit të ankesave të ankuesit është i njëjtë, me datë 25.03.2022 ka nxjerrë vendimin me numër:17/2022 për bashkimin e ankesave të ankuesit, asaj me numër A.nr.110/2022 të datës 10.02.2022 dhe A.nr.225/2022 të datës 11.03.2022.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave ka administruar këto prova: Vendimin me numër:17/2022 për bashkimin e ankesave të ankuesit i nxjerrë nga Kryetari i KPMSHCK-së; Ankesën e ankuesit të datës 11.03.2022 e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Dëshminë e datës 07.02.2022 për pranimin e aktit administrativ të goditur; Vendimit numër: 01/194 të Komisionit Disiplinor të Komunës së Malishevës i datës 08.02.2022; Zarfën postar të datës 09.03.2022 me shifër R1398773; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 15.03.2022; Përgjigjen në kërkesë të datës 30.03.2022; Njoftimin e datës 17.12.2022 me numër 01/1195 dërguar Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nga Menaxheri i Personelit të Komunës së Malishevës; Akt emërimit e ankuesit të datës 17.12.2021 me numër:01/1192; Kërkesën e datës 19.01.2022 nga Drejtori i Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për Udhëheqësin e Personelit; Raportin për inicimin e procedurës disiplinore të datës 25.01.2022; Vërejtja e datës 27.01.2022 me numër:08/08; Ftesën e datës 02.02.2022 me numër 01/165; Kopjen e Librit të pranimit, Kopjen e librit të pranimit i datës 25.01.2022; Kërkesën e pushimit pa pagesë të datës 12.01.2022; Njoftimin e datës 08.12.2022; Aktvendimin e Kryetarit të Komunës i datës 21.01.2022; Njoftimin për aktgjykim të datës 13.08.2021 me numër ref:1726/21 i Gjykatës Kushtetuese; Vendimin e Këshillit të datës 24.04.2006; Përgjigje në ankesë të datës 28.08.2018; Ankesën e datës 20.08.2018 të Cp.nr.118/2018 parashtruar në Gjykatën Themelore në Gjakovë-Dega Malishevë; Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë me numër Ac.nr.3983/2018; Zarfën postar të datës 28.03.2022 me shifër R2180817; Ankesën e ankuesit të datës 10.02.2022 të parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil; Aktgjykimin në rastin nr.K1175/19 të Gjykatës Kushtetuese i datës 09.08.2021; Njoftimin e komunës së Malishevës të datës 17 janar i orës 04:52; Shkresën me përmbajtjen e sms i datës 25.01.2022; Shkresën e datës 26 janar 2022; Shkresën e datës 13 janar; Zarfën postar të datës 08.02.2022 me shifër R2049549; Kërkesën për përgjigje në ankesë të datës 18.02.2022; Aktvendimin e datës 05.02.2018 me numër:01/136; Vendimin e Kryetarit të Komunës së Malishevës i datës 14.01.2022 me numër:01/64;

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, për vendosjen e kësaj çështje ka shqyrtuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët në procedurë dhe ka konstatuar se ankesa e ankuesit është e pabazuar, sepse:

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave në bazë të shkresave të lëndës, respektivisht sipas Aktgjykimit në rastin nr.K1175/19 të datës 09.08.2021 me numër ref:AGJ 1822/21 të Gjykatës Kushtetuese ka konstatuar se e njëjta ka vendosur dhe konstatuar se moszbatimi i Vendimit të Këshillit nr.738 i datës 18 prill 2006 ka shkaktuar shkelje të nenin 31 të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, njëherit e ka urdhëruar Komunën e Malishevës të zbatoj vendimin e Këshillit me numër 738 të datës 18.04.2006, ndërsa Komuna e Malishevës me qëllim të zbatimit të Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese me datë 17.12.2021 dhe numër 01/1192 i ka ofruar ankuesit aktin e emërimit në titullin e vendit të punës: "Zyrtar i Pylltarisë EZIIE/480" në Drejtorinë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural i cili akt emërim është nënshkruar edhe nga ankuesi.

Po ashtu, Kolegji në bazë të shkresave të lëndës ka gjetur se ankuesi sipas akt emërimit të datës 17.12.2021 dhe numër 01/1192 të cilin e ka nënshkruar dhe pranuar, data e fillimit të punës ka qenë e përcaktuar 03.01.2022, ndërsa i njëjti me datë 12.01.2022 i është drejtuar Kryetarit të Komunës së Malishevës me kërkesën për pushim



pa pagesë për periudhën një (1) vjeçare duke iu referuar Ligjit Nr.03/L-149 për Shërbimin Civil të Republikës Kosovës me arsyetimin se, citoj: "KK-Malishevë nuk e ka zbatu në plotëni vendimin e Gjykatës Kushtetuese Nr.K1175/19 lënda është kthyer, në Gjykatën Kushtetuese", ndërsa Kryetari i Komunës së Malishevës me datë 21.01.2022 ka nxjerr aktvendimin me numër:01/2022 me të cilën ankuesit ia ka refuzuar kërkesën për pushim pa pagesë për shkak që i njëjti nuk i ka përfillur procedurat e kërkuara ligjore të parashtrimit të ankesës si dhe nuk ka ofruar asnjë dëshmi shtesë që e mbështetë kërkesën për pushim pa pagesë.

Kolegji thekson faktin se në kohën kur është parashtruar kërkesa e ankuesit me datë 12.01.2022 për pushimin pa pagesë me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë së kërkesës për pushim pa pagesë të ankuesit ka analizuar dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik i cili sipas Aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese në rastin nr. KO203/19 ka hyrë në fuqi nga data 09.07.2020, dhe në nenin 18 paragrafi 4 dhe 5 i të njëjtit ligj përcaktohet se: "Pushimet e zyrtarëve publikë rregullohen sipas legjislacionit të punës; Kriteret dhe kushtet e orarit të punës dhe të pushimeve përcaktohen nga Qeveria me akt nënligjor, pas propozimit të ministrisë përgjegjëse për administratën publike dhe ministrisë përgjegjëse për punë", po ashtu neni 41 paragrafi 1 dhe 2 i Ligji Nr. 03/L-212 i Punës përcakton se: "Në bazë të kërkesës së të punësuarit, punëdhënësi mund të lejojë që i punësuarit të mungojë nga puna pa kompensim të pagës. Për kohën e mungesës në punë pa kompensim të pagës nga paragrafi 1, i këtij neni, të punësuarit i pushojnë të drejtat dhe detyrat nga marrëdhënia e punës, përveç të drejtave të cilat burojnë nga pagesa e detyrueshme e kontributeve nga ana e të punësuarit" ndërsa me nenin 14 paragrafi 1, 2 dhe 3 të Rregullores (QRK) NR.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë përcakton se: "1. Zyrtari publike gëzon të drejtën për pushimi pa pagesë në pajtim me dispozitat e Ligjit të punës. 2. Në raste të veçanta zyrtari publik mund të përfitojë pushim pa pagesë, për nevoja të: 2.1. ngritjes apo arsimimit më të lartë profesional; 2.2. shëndetit të tij/saj, apo pjesëtarëve të familjes së ngushtë; 2.3. për transferim të përkohshëm në detyra të tjera brenda apo jashtë vendit; 2.4. për kandidim në zgjedhjet komunale apo qendrore. 3. Për realizimin e të drejtës për pushim pa pagesë sipas paragrafit 1 të këtij neni zyrtari publik duhet të paraqet kërkesën e arsyetuar për pushim pa pagesë. Kërkesa duhet të dorëzohet jo më pak se pesëmbëdhjetë (15) ditë përpara tek mbikëqyrësi i drejtpërdrejtë, i cili bashkë me rekomandimin e tij/saj e përcjell për vendimmarrje tek nëpunësi më i lartë civil i institucionit. Vendimi i dorëzohet pa vonesë Zyrtarit dhe Njesisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore". andaj mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se nëpunësve civil u takon pushimi pa pagesë mirëpo vetëm në rastet kur plotësohen parakushtet e përcaktuara me 14 paragrafi 2 dh 3 të Rregullores (QRK) NR.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë, ndërsa në rastin konkret ankuesi asnjërin nga kriteret dhe parakushtet e përcaktuara nuk e ka plotësuar, ose të paktën nuk e ka dëshmuar me rastin e parashtrimit kërkesës me datë 21.01.2022 të kryetari i Komunës apo me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshill me datë 10.02.2022 dhe se vendimi i Kryetarit të Komunës së Malishevës i datës 21.01.2022 për refuzimin e kërkesës së ankuesit për pushim pa pagesë është i bazuar në dispozitat e aplikuara ligjore për Shërbimin Civil.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave po ashtu ka gjetur se Drejtori i Drejtorisë së Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural nëpërmjet shkresë së datës 19.01.2022 i është drejtuar Njesisë së Burimeve Njerëzore me kërkesën për marrjen e masave dhe njoftimin se ankuesi që nga data 13.01.2022 është duke munguar në vendin e punës pa asnjë arsye, dhe po ashtu Drejtori i Drejtorisë për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural me datë 27.01.2021 ka paraqitur raportin për iniciimin e procedurës disiplinore ndaj ankuesit me arsyetimin se i njëjti që nga data 12.01.2022 deri me datën e 27.01.2022 nuk është paraqitur në punë, ndërsa Komisioni Disiplinor me datë 08.02.2022 ka nxjerr vendimin me numër:01/194 duke i shqiptuar ankuesit masën disiplinore: *Largim nga Shërbimi Civil*".

Kolegji ka shqyrtuar pretendimet ankimore të ankuesit i cili pretendon se përbërja e Komisionit Disiplinor nuk ka pasur përfaqësues nga Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural, ftesën e kam pranuar me datë 07.02.2022 dhe nuk më është dhënë mundësia t'i tregoj arsyet e mos pranisë në punë si dhe Komisioni Disiplinor ka tejkaluar kompetencat e tij pasi që nuk kam pasur marrëdhënie të punës me Komisionin Disiplinor por me komunën e cila përfaqësohet nga kryetari i komunës dhe se Komisioni Disiplinor ka mundur të rekomandoj por jo të ma ndërprerje marrëdhënien e punës, akt emërimit në fjalë. Ndërsa, po ashtu bazën e shkresave të lëndës

të ofruara në cilësi të provave nga palët në procedurë Kolegji ka konstatuar se ankuesi me rastin e nënshkrimit të aktit të emërimit të datës 17.12.2021 i cili ka përcaktuar se marrëdhënie e punës fillon me datë 03.01.2022 ka qenë i obliguar edhe sipas Aktit të emërimit në pikën IV të përmbush të gjitha obligimet në pajtim me dispozitat ligjore të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, mirëpo i njëjta që nga momenti i parashtrimit të kërkesës tek Kryetari i Komunës për pushim pa pagesë me datë 12.01.2022 ka munguar në punë të paktën deri në momentin e nxjerrjes së vendimit të Komisionit Disiplinor i datës 08.02.2022

Me qëllim të vlerësimit të ligjshmërisë dhe besueshmërisë së pretendimeve ankimore të ankuesit, Kolegji ka analizuar dispozitat e aplikuara ligjore në fuq për shërbimin civil, ndërsa referuar nenit 10 paragrafi 1 dhe 2 të Rregullores Nr. 11/2020 për Disiplinën dhe Ankesat e Zyrtarëve Publikë ku përcaktohet themelimi dhe përbërja e Komisionit Disiplinor nuk ka përcaktuar që njëri anëtar duhet të jetë nga Sektori-Divizioni-Drejtoria apo Departamenti, respektivisht Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Zhvillim Rural në kuadër të së cilës është i sistemuar pala ankuese, andaj në këtë pjesë pretendimi ankimor i ankuesit është i pabazuar. Po ashtu kolegji konstaton se Komisioni Disiplinor është përgjegjës për shqyrtimin e shkeljeve të rënda të punës siç përcaktohet edhe nenin 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Masat disiplinore të parashikuara në paragrafin 1.2 deri 1.4 të nenit 47 të këtij ligji, janë në kompetencën e komisionit disiplinor"* ndërlidhur me nenin 47 paragrafi 1 nën paragrafët 1.2, 1.3 dhe 1.4 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *"Masat disiplinore, të cilat mund të zbatohen ndaj nëpunësit civil, janë: 2. ndalimi nga 20% deri në 40% e pagës për një periudhë deri në gjashtë muaj; 1.3. ndalimi i ngritjes në detyrë, duke përfshirë këtu rritjen në shkallën e pagës për një periudhë nga dy deri 5 vjet; 1.4. largimi nga Shërbimi Civil"*, ndërsa ankuesi sipas shkresave të lëndës është konstatuar se ka kryer shkelje të rënda të detyrave të punës siç përcaktohet me nenin 46 paragrafi 1 dhe 2 nën paragrafi 2.1 si dhe paragrafi 3 nën paragrafi 3.5 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore. 2. Shkeljet disiplinore ndahen në: 2.1. shkelje të rënda; 3. Shkelje të rënda konsiderohen: . braktisja e punës ose mungesa e paarsyeshme dhe e vijueshme për pesë (5) ditë pune apo më shumë"*, ndërsa tek ankuesi është konstatuar se i njëjti ka munguar më shumë se pesë (5) ditë në punë.

Ndërsa sa i përket pretendimit ankimor të ankuesit lidhur me ftesën nga ana e Komisionit Disiplinor në bazë të shkresave të lëndës, Kolegji ka konstatuar se me datë 02.02.2022 është përcjellë ftesa përmes poste, ndërsa në nenin 12 paragrafi 3 nën paragrafi 3.3 të Rregullores (QRK) NR.12/2020 për Orarin e Punës dhe Pushimet e Zyrtarëve Publikë përcaktohet se: *"Komisioni disiplinor kryen edhe këto veprime deri në marrjen e vendimit: Fton iniciuesin dhe nëpunësin civil ndaj të cilit është iniciuar procedura disiplinore për t'u njohur me variantin e tyre të ngjarjes apo të problemit"*, andaj mbi këtë bazë Kolegji vlerëson se Komisioni Disiplinor e ka ndërmarr këtë veprim me rastin e përcjelljes së ftesës ankuesit të datës 02.02.2022, mirëpo për mungesën eventuale të ankuesit në seancë në rastet kur ftesa i është përcjellë palës dispozitat e kësaj rregulloreje nuk kanë përcaktuar ndonjë detyrim tjetër.

Po ashtu, ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës, nuk ka ofruar prova bindëse madje as një dëshmi të vetme e cila është e provueshme dhe e arsyeton mungesën e tij në vendin e punës për më shumë se pesë (5) ditë pune, përkundër detyrimeve ligjore që rrjedhin nga marrëdhënia e punës referuar Aktit të emërimit të datës 17.12.2022 sikurse përcaktohet edhe me nenin 25 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik ku përcaktohet se: *"Zyrtari publik duhet të veprojë në përputhje me parimet e përcaktuara me këtë ligj, kodin e etikës dhe veprimet e tij duhet të jenë në funksion të themelimit dhe përforcimit të besimit të ndërsjellë dhe bashkëpunimit ndërmjet qytetarëve dhe administratës publike"* si dhe nenin 28 i të njëjtit ligj ku përcaktohet se: *"Zyrtari publik gjatë punës së tij duhet të jetë i përgjegjshëm dhe gjatë ushtrimit të detyrës mban përgjegjësi të plotë sipas ligjit, për çdo veprim apo mosveprim të tij"*. Kolegji vë në mendje po ashtu, se është për tu theksuar fakti se Komisioni Disiplinor në vendimin e datës 08.02.2021 në pjesën e arsyetimit potencohet dyshimi se ankuesi është duke punuar edhe në institucionin

mikrofinanciar "FINCA" në Malishevë, ndërsa ankuesi me rastin e parashtrimit të ankesës në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës të Shërbimit Civil të Kosovës nuk e ka mohuar e as pohuar një gjë të tillë.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafin 1.1 si dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh, nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Iniciimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

**KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS**  
**Lënda me numër A.nr.225/2022**

**Flakron GASHI**



Zyrtar i Lartë për Bëhëpunim Profesional



**Eshref SHABANI**

Kryetari i Kolegjit

**Vendimi i dërgohet:**

- Ankuesit
- Kryetarit të Komunes së Malishevës;
- Menaxherit të Personelit të Komunës së Malishevës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

